



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 10.03.2025
Numër Protokolli: 1599/2025

A.nr.180/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.180/2025 të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.M., kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.180/2025 të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.M.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, A.M.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 23.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 481/2025, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.180/2025, në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Konkursit me numër reference RN00015138, të shpallur me datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, për pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, ***sepse:***

Nga provat e administruara të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës, më datë 13.09.2024 ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00015138, për gjashtë (6) pozitat e punës “*Inspektor i Punës*” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit, ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.09.2024 deri më 13.10.2024.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 159 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesi, ndërsa pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, më datë 24.12.2024 është publikuar Njoftimi me numër protokolli 3376 për kandidatët fitues, nga i cili njoftim rezulton se A.D-

B me 83.6 pikë, L.Z me 82.6 pikë, B.M me 82.4 pikë dhe Q.Sh me 77.4 pikë të arritura janë shpallur kandidatë fitues për pozitat e punës “Inspektor i Punës” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni i Pranimi i cili ka vlerësuar kandidatët në këtë procedurë rekrutimi ka qenë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara ligjore, rrjedhimisht nuk ka pasur autoritet për kryerjen e këtyrave procedurave, andaj kërkon që aprovohet ankesa dhe të anulohet në tërësi konkursi në fjalë.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankesë është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur me Vendimin A.nr.166/2025 të datës 07.03.2025, me të cilin vendim është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015138, për gjashtë (6) pozitat e punës “Inspektor i Punës” pranë Divizionit të Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit, i shpallur më datë 13.09.2024 nga Inspektorati i Punës, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.166/2025 të datës 07.03.2025 është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015138, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankesë është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundojë procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.180/2025, të datës 23.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.180/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.M.;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së